


ÇFARË ËSHTË CEFTA ?



ÇFARË ËSHTË CEFTA ?

CEFTA (Central European Free Trade Agreement) është një marrëveshje e tregtisë se lire ne të cilën marrin pjesë tetë vende të rajonit të Ballkanit Perëndimor: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Moldavia.

Marrëveshja e pare e CEFTA-s u nënshkrua nga Polonia, Hungaria, Çekia dhe Sllovakia ne Dhjetor 1992 dhe hyri ne fuqi ne Korrik 1994. Nëpërmjet CEFTA-s këto vende pjesëmarrëse u mobilizuan për t'iu qasur institucioneve politike, ligjore dhe ekonomike Bashkimit Evropian, duke forcuar ne këtë mënyrë

demokracinë dhe ekonomitë e tyre te tregut. Sllovenia iu bashkua CEFTA-s ne 1996, Rumania ne 1997, Bullgaria ne 1999, Kroacia ne 2003 dhe Maqedonia ne 2006.

Meqenëse ne 2007 te gjitha palët e mëparshme te CEFTA-s kishin hyre ne Bashkimin Evropian dhe kishin dale nga CEFTA, u vendos qe CEFTA te shtrihej ne pjesën e Ballkanit te mbetur jashtë BE-se. Ne këtë kohe Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Moldavia kishin nënshkruar një numër te madh marrëveshjesh bilaterale te tregtisë se lire ne kuadrin e Paktit te Stabilitetit për Evropën Juglindore. Këto u zëvendësuan nga një marrëveshje e vetme multilaterale - CEFTA. Ne shtypin dhe media e Kosovës kohet e fundit është folur shume për CEFTA-n dhe për ndikimin e saj ne ekonominë e Kosovës.

Përgjithësisht diskutimet janë përqendruar ne aspekte te shkëputura te CEFTA-s, sidomos ne liberalizmin e tarifave doganore me vendet e rajonit. Mirëpo ne te vërtete, duke qene një marrëveshje me një natyre shume-dimensionale, CEFTA është shume me tepër sesa thjesht një marrëveshje për tarifat doganore. Ne këtë aspekt, është shume e rëndësishme qe CEFTA te shihet ne një kontekst me te gjere dhe nga këndvështrime te ndryshme ne mënyre qe te kuptohet për atë fare ajo është ne te vërtete. Si fillim është i nevojshëm një shpjegim i shkurtër i përmbajtjes dhe qëllimit te CEFTA-s. Nga këndvështrimi politik, CEFTA është pjese e përpjekjeve te vendeve te rajonit dhe Bashkimit Evropian (BE) për te krijuar një treg rajonal qe mundëson zhvillimin ekonomik dhe qe do e kontribuojë eventualisht ne rritjen e sigurisë dhe stabilitetit politik ne Ballkan.



Z. Lutfi Zharku,
Ministër i Tregtisë dhe Industrisë

te

CEFTA eshte vetem nje element i integritit ekonomik rajonal. Elemente po aq te rëndesishem te ketij integriti jane iniciativa ne fusha te tjera si Komuniteti i Enegjise, Zona e Perbashket e Aviacionit, Memorandumi i Europes Juglindore ne fushen e Transportit, Iniciativa e Evropes Juglindore ne fushen e Telekomunikacioneve dhe Internetit, Kompakti i Investimeve, etj. Te gjitha keto iniciativa synojne krijimin e nje tergu te perbashket rajonal qe ne nje faze te mevonshme do te integrohet ne tregun e madh European.

Ne fakt, CEFTA eshte nje instrument i para-hyrjes (pre-accession) ne BE. Cdo vend i ish-bllokut komunist qe eshte bere anetar i BE-se sot, ka qene me pare anetar i CEFTA-s. Ne te njejten menyre, cdo vend qe eshte ne procesin e hyrjes ne BE, eshte bere sot anetar i CEFTA-s.

Hyrja eventuale e Kosoves ne BE kerkon pregatitje ne aspektin institucional dhe ne ate te administrimit te marredhenieve me vendet e tjera anetare. Me specifikesht, hyrja e Kosoves ne BE do te thote liberalizim dhe intensifikim i marredhenieve tregtare me vendet e BE-se. Nga ky kendveshtrim, CEFTA i ofron Kosoves nje mundesi per tu ushtruar dhe per tu mesuar me rregullat e lojes ne nje treg rajonal ne menyre qe procesi i integritit ne BE te perballohet me sukses. Te gjitha vendet e tjera ish-komuniste kane kaluar ne kete proces.

Nga kendveshtrimi ekonomik, CEFTA do te ndihmoje zhvillimin ekonomik ne rajon me ane te liberalizimit dhe zhvillimit te tregtise. Eksperienca boterore e ka provuar se vendet qe ia mbyllin dyert tregtise ia mbyllin dyert zhvillimit. Shqiperia e viteve te komunizmit dhe Koreja e Veriut e diteve te sotme jane shembuj tipike te deshtimit te politikave te izolimit dhe mbylljes se dyerve. Qe ne kohet e lashta, shkembimet tregtare kane qene faktori me i rëndesishem i zhvillimit kulturor dhe ekonomik te rajoneve, shteteve e perandorive.

Menyra se si CEFTA do te lehtesoje zhvillimin e tregtise eshte nepermjet bashkepunimit me te ngushte midis vendeve pjesemarrese ne nivele politike dhe teknike; harmonizmit te politikave, institucioneve dhe rregullave qe lidhen me tregtine; liberalizmit te tarifave doganore; eleminimit te barrierave jo-tarifore; dhe, aplikimit te rregullave te favorshme te origjines.

Sic e cekta edhe me lart, eshte e rëndesishme te kuptohet qe zbatimi i CEFTA-s nuk lidhet vetem me liberalizimin e tarifave doganore ne tregtine me vendet e rajonit. Perkundrazi, tarifat doganore jane vetem nje pjese e vogel e asaj cka perfshin CEFTA. Ne kete ligjerate nuk do te ndalem ne hollesite teknike te asaj cka permban CEFTA por do te perpiqem te perqendrohem ne elementet me te rëndesishme.

Nje nga fushat me te rëndesishme qe prek CEFTA eshte ajo e Barrierave Teknike dhe Masave Sanitare

Dhe Fitosanitare. CEFTA do ti mundesoje vendet pjesemarrese te harmonizojne standartet teknike dhe masat sanitare dhe fitosanitare qe ato perdorin per te siguruar shendetin e njerezve, kafsheve dhe bimeve te tyre. Shpesh standartet teknike dhe masat sanitare dhe fitosanitare perdoren per te penguar tregtine e lire te mallrave ose per te diskriminuar mallrat e nje vendi te caktuar. Nepermjet krijimit te nje forumi te perbashket, CEFTA do te beje te mundur qe keto masa te mos behen pengese kunder tregtise se lire dhe te perdoren vetem atehere kur jane shkencerisht te justifikueshme



Ky element i CEFTA-s eshte shume i rendesishem per tregtaret Kosovare. Eshte fakt qe gjate viteve te fundit tregtaret Kosovare jane perballur me lloje te ndryshme barrierash jo-tarifore. Per shembull, ne disa raste atyre nuk u eshte njohur origjina e mallit te tyre, ne raste te tjera nuk u jane njohur tabelat e automjeteve, shume here u eshte ndaluar eksporti i prodhimeve ushqimore per shkak te mosnjohjes se certifikateve sanitare, kurse here te tjera jane mbajtur

per procedura doganore ne doganat e vendeve fqinje per dite te tera duke iu shkaktuar humbje te medha financiare.

CEFTA ofron nje forum ku keto probleme te diskutohen ne nivel rajonal dhe te zgjidhen efektivisht. Me pare institucionet kosovare kane qene te detyruara ti ngrene keto probleme ne menyre bilaterale. Ne forume bilaterale fuqia e Kosoves ka qene e kufizuar, jo pak edhe per shkak te Statusit te paqarte. Ky problem eliminohet nepermjet CEFTA-s. Ne kete forum multilateral fuqia e Kosoves rritet per shkak se mbi vendin qe thyen rregullat e perbashketa dhe bllokon tregtine e lire ne menyre diskriminuese ushtrojne presion te gjitha palet bashke. Eshte e rendesishme te theksohet qe CEFTA i mundeson Kosoves zgjidhjen e problemeve tregtare me Serbine, gje e cila deri me sot ka qene praktikisht e pamundur per shkaqe qe dihen.

Nje tjeter element i rendesishem i CEFTA-s jane rregullat e origjines. CEFTA i lejon prodhuesve Kosovare te importojne lende te para nga vendet pjesemarrese te CEFTA-s dhe ti perdorin ato per perftimin e prodhimeve kosovare pa e rrezikuar origjinen Kosovare te prodhimit perfundimtar. Me fjale te tjera, cdo lende e pare e importuar nga vendet e CEFTA-s mund te perdoret sikur te ishte prodhim Kosovar dhe produkti perfundimtar mund te eksportohet me tarife doganore zero (trajtim preferencial) ne secilin vend te CEFTA-s. Ne marreveshjet bilaterale te tregtise se lire ky perfitim nuk ishte i mundur. Per te mos e rrezikuar origjinen e prodhimit te tij, nje prodhues kosovar ishte i detyruar te perdorte vetem lende te para nga vendi ku do ta eksportonte prodhimin perfundimtar. Ndersa CEFTA i lejon ketij prodhuesi te importoje lende te pare nga cilido vend i CEFTA-s dhe ta eksportoje produktin perfundimtar ne cilindo vend te CEFTA-s.

Cfare është origjina e mallit?

Ashtu si çdo njeri i përket një vendi të veçantë, edhe mallrat kanë një origjinë të caktuar. Në rastin kur malli prodhohet krejtësisht në një vend, origjina e tij është e qartë. Për shembull prodhimet bujqësore, blegtorale, pyjore, minerale (në përgjithësi lende të para) marrin automatikisht origjinën e vendit ku prodhohen. Por një pjesë e madhe e mallrave (kryesisht ato të përpunuara) prodhohen duke përdorur inpute ose pjesë të importuara nga një vend tjetër. Për shembull, lëngu i frutave të prodhuar në Kosovë mund të jetë përftuar duke përdorur ekstrakte të frutave të importuara nga Maqedonia dhe sheqer të importuar nga Turqia. Në këtë situatë, beshjtja që shtrohet është: “*lëngu i prodhuar në Kosovë a do të ketë origjinë Kosovare, Maqedonase apo Turke*”? Vendosja e kriterëve të qarta për përcaktimin e origjinës së mallrave i jep përgjigje të sakte kësaj pyetjeje.

Pse është koncepti i origjinës së mallit i rëndësishëm?

Koncepti i origjinës së mallit bëhet i rëndësishëm në rastin e trajtimit preferencial që një vend i bën prodhimeve të një vendi tjetër. Për shembull, nëpërmjet sistemit të “Preferencave Tregtare Autonome”, Bashkimi Evropian i lejon prodhimet Kosovare të hyjnë në tregun e përbashkët Evropian pa ndonjë tatim doganor. Nga ana tjetër, prodhimet Kineze, për shembull, nuk e gëzojnë këtë trajtim preferencial. Në këtë situatë, për Bashkimin Evropian është e rëndësishme që vetëm mallrat Kosovare të përfitojnë nga ky trajtim. Mallrat e importuara në Kosovë nga Kina nuk duhet të hyjnë në BE duke përfituar nga trajtimi preferencial që i është akorduar vetëm Kosovës. Gjithashtu, mallrat e importuara nga Kina dhe që nuk kanë pësuar ndonjë përpunim apo transformim të rëndësishëm në Kosovë (p.sh. vetëm paketim dhe etiketim) nuk mund të hyjnë në BE duke përfituar trajtimin preferencial që i përket Kosovës. Për këto arsye është e nevojshme të përcaktohet qartë se cilat mallra do të njihen nga BE si mallra të Kosovës. Kjo heshtje zgjidhet me anë të konceptit të “rregullit të origjinës” **Si përcaktohet origjina e mallit?**

Siç u përmend edhe më lart, kur malli është prodhuar në një etapë të vetme ose përftohet krejtësisht në një vend të vetëm, atëherë origjina e tij është relativisht e lehtë për tu përcaktuar. Në rastet kur malli është prodhuar duke përdorur materiale ose pjesë të importuara nga një vend tjetër, për të përcaktuar origjinën e tij përdoren rregullat e origjinës.

Këto rregulla përcaktojnë metodën që përdoret për të vlerësuar nëse malli në fjale ka pësuar *përpunim të mjaftueshëm* ose i është nënshtruar një *transformimi thelbësor* në mënyrë që të marrë origjinën e vendit ku u krye ky përpunim ose transformim.

**Cfare
benefitesh
konkrete sjell
CEFTA
nëpërmjet
Rregullave të
Origjinës?**

Cili përpunim është i mjaftueshëm dhe sa thelbësor duhet të jetë transformimi në mënyrë që malli të marrë origjinën e vendit ku është bërë transformimi? Për këto përdoren disa kritere që masin shkallën e transformimit.

Fatkeqësisht, nuk ekziston një rregull origjine i thjeshtë, standard dhe universal për të gjitha vendet. Në praktikën tregtare zakonisht përdoren tre metoda kryesore për të përcaktuar nëse *përpunimi ka gene* i mjaftueshëm dhe *transformimi thelbësor*:

- Ndryshimi i klasifikimit tarifor sipas Nomenklatures Doganore;
- Sasia minimale e vlerës së shtuar (përqindja e vlerës);
- Një proces i caktuar i përpunimit;
- Kombinimi i metodave të mësipërme.

Asnjë nga këto metoda nuk është superiore. Secila ka të mirat dhe dobësitë e veta. Disa marrëveshje të tregtisë përdorin vetëm një metodë për të gjitha llojet e mallrave.

Çfarë është Akumulimi?

Akumulimi është një instrument që i lejon prodhuesit të importojnë inpute nga një vend specifik ose një grup vendesh të një rajoni dhe të përdorin ato për të prodhuar një produkt pa e rrezikuar origjinën e këtij produkti. Me fjale të tjera, akumulimit Ben të mundur që inputet e importuara nga vendet e tjera të përdoren sikur të kishin origjinën e vendit ku bëhet përpunimi.

Forma më e thjeshtë e akumulimit është ajo *bilaterale*. Akumulimi bilateral përfshin dy vende partnere. Për shembull, nëpërmjet akumulimit bilateral, një prodhues nga Kosova mund të importojë lende të para që mbartin origjinën e vendit partner dhe të përdorë këto lende të para sikur ato të kishin origjinën nga Kosova, për ta eksportuar më pas produktin përfundimtar në vendin partner.

Një formë tjetër e akumulimit është ai *diagonal*. Akumulimi diagonal përfshin një grup rajonal vendesh partnere. Nëpërmjet akumulimit diagonal, një prodhues nga Kosova mund të importojë lende të para që mbartin origjinën e çdo vendi të grupit rajonal dhe të përdorë këto lende të para sikur ato të kishin origjinën nga Kosova, për ta eksportuar më pas produktin përfundimtar në cilindo nga vendet partnere.

Cilat janë rregullat e origjinës për ne Marrëveshjen e CEFTA-s dhe si ndryshojnë ato nga rregullat e përdorura ne Marrëveshjet Bilaterale

Ne marrëveshjet bilaterale te tregtisë se lire përdoren te terja llojet e metodave te përmendura me lart për te përcaktuar origjinën. Çdo marrëveshje ka një liste shume te gjate prodhimesh dhe grup-prodhimesh për te cilat specifikohet qarte metoda qe përdoret për përcaktimin e origjinës.

Akumulimi qe aplikohet ne këto marrëveshje është ai bilateral. Mënyra se si funksionon ky lloj akumulimi mund te shpjegohet me një shembull konkret.

Një prodhues Kosovar mund te blejë pëlhere nga Maqedonia dhe te prodhoje rroba. Nëse nuk do te aplikohej akumulimi bilateral me Maqedoninë, rrobat e prodhuara ne Kosove nuk do te përftonin origjinën Kosovare sepse përpunimi i bere ne Kosove nuk do te ishte i mjaftueshëm (transformimi i mjaftueshëm do te ishte nga fill ne rroba). Ne këtë rast ky mall do te hynte ne Maqedoni me tarifën jo-preferenciale qe aplikon Maqedonia.

Mirëpo me ane te marrëveshjes bilaterale, Kosova e akumulon origjinën me Maqedoninë. Kjo do te thotë qe pëlhura e importuar nga Maqedonia konsiderohet me origjine Kosovare. Ne këtë mënyre plotësohet kushti i transformimit te mjaftueshëm dhe rrobat e përftuara marrin origjinën Kosovare dhe mund te eksportohen përsëri ne Maqedoni me tarife zero. E njëjta gjë ndodh me vendet e tjera me te cilat Kosova ka marrëveshje bilaterale (Shqipëria, Bostia, Kroacia).

Megjithatë është e rëndësishme te kuptohet qe nëse prodhuesi Kosovar e blen pëlhurën ne Maqedoni, ai nuk mund ti eksportoje rrobat me tarife zero ne Shqipëri sepse origjina nuk akumulohet kur lënda e pare (pëlhura) është blere jashtë Shqipërisë. Domethënë akumulimi behet vetëm midis dy palëve (Kosove – Maqedoni, ose Kosove – Shqipëri, ose Kosove – Mal i Zi, etj.). Marrëveshjet bilaterale te tregtisë se lire tashme janë zëvendësuar nga marrëveshja e CEFTA-s. Ne baze te kësaj marrëveshje, prodhimet me origjine Kosovare kane mundësi te hyjnë me tarife zero ne vendet anëtare te CEFTA-s (Maqedoni, Shqipëri, Serbi, Mal i Zi, Bostia dhe Hercegovina, Kroaci dhe Moldavi).

Ne këtë marrëveshje, te terja metodat e përmendura me lart përdoren për te përcaktuar origjinën e mallrave. Lista e metodës qe përdoret për secilin produkt ose grup produktesh është shume e gjate.

Akumulimi qe aplikohet ne këtë marrëveshje është ai diagonal. Mënyra se si funksionon ky lloj akumulimi mund te shpjegohet me një shembull konkret.

Një prodhues Kosovar mund të blejë pëlhurë nga një vend i CEFTA-s, p.sh. Maqedonia, dhe të prodhojë rroba. Pëlhura e importuar nga Maqedonia konsiderohet me origjinë Kosovare dhe transformimi në rroba është i mjaftueshëm për të kënaqur rregullin e origjinës. Rrobat e përfuara marrin origjinën Kosovare dhe mund të eksportohen me tarife zero jo vetëm në Maqedoni (siç ishte rasti i marrëveshjeve bilaterale) por në çdo vend tjetër anëtar të CEFTA-s.

CEFTA merr në konsideratë edhe rastet e mundshme kur tregu i një vendi dëmtohet nga importet e një vendi partner në marrëveshje. Për të krijuar vendeve pjesëmarrëse mundësi për të mbrojtur sektorët ose aktivitetet e tyre, CEFTA lejon përdorimin e instrumenteve të Anit-dumping-ut dhe Masave Mbrojtëse. Anit-dumpingu, për shembull, është një politikë që lejon ngritjen e tarifave doganore ose vendosjen e kufizimeve në import kur vihet re që prodhimi i një vendi të caktuar shitet në tregun e Kosovës nën çmimin real të prodhimit. Kjo mund të ndodhë në rastin kur në një vend partner ka prodhim shumë të madh të një produkti të caktuar dhe e hedh prodhimin e tepërt në Kosovë duke e shitur nën koston e prodhimit. Në këtë rast, nëse në mund të provojmë se ky prodhim i importit po shkakton dëmtime serioze të prodhimit vendor, kemi të drejtë të kufizojmë përkohësisht importet nga vendi në fjalë nëpërmjet tarifave me të larta ose kuotave të përkohshme. Masat mbrojtëse përdoren në mënyrë të ngjashme si anit-dumpingu, por ato ndërmerren edhe kur çmimi i importit është mbi koston e prodhimit - e rëndësishme është të provohet se importi po shkakton dëmtim serioz të sektorëve të caktuar. Element tjetër i rëndësishëm i CEFTA-s është liberalizimi gradual i sektorëve të Shërbimeve, Investimeve dhe Prokurimeve Qeveritare. Në këto sektorë synohet hapja ndaj konkurrencës së lire në rajon dhe eliminimi i diskriminimit të investitorëve rajonale. Ky liberalizim do të mundësojë bizneset kosovare të veprojnë në tregjet e vendeve partnere në mënyrë të barabartë e të pa diskriminuar.

Në fushën e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale CEFTA synon mbrojtje me efektive të këtyre të drejtave. Qëllimi është tërheqja e investimeve të huaja dhe promovimi i investimeve reciproke ndërmjet vendeve anëtare duke mbrojtur pronësinë intelektuale të investitorëve në mënyrë uniforme përgjatë gjithë rajonit. **Si ndërlidhet CEFTA me Marrëveshjet Bilaterale të Tregtisë së Lire?**

Kosova gjatë katër viteve të fundit, nën kuadrin e Paktit të Stabilitetit (iniciative kjo e promovuar nga Bashkimi Evropian), ka negociuar dhe nënshkruar katër Marrëveshje Bilaterale të Tregtisë së Lire me vendet fqinje: Shqipëria, Maqedonia, Bostia dhe Hercegovina, dhe Kroacia.

Qëllimi i këtyre marrëveshjeve ka qenë përmirësimi i bashkëpunimit tregtar dhe rritja e shkëmbimit të mallrave me këto vende. Nga aspekti tarifor, me Shqipërinë dhe Bosnjën është bërë liberalizimi i plotë i tregtisë, ndërsa me Maqedoninë dhe Kroacinë është arritur një liberalizim asimetrik, që do të

thote qe produktet e Kosoves hyjne pa detyrim doganor ne keto vende, ndersa disa prodhime sensitive te Kosoves jane te mbrojtura me ane te aplikimit te detyrimit doganor ne Kosove.

Nen kuadrin e Paktit te Stabilitetit, te gjitha vendet e rajonit kane nenshkruar marreveshje bilaterale te tregtise midis tyre. Pas nje ekperience te suksesshme disa-vjecare me marreveshjet bilaterale, gjate vitit 2006 vendet e rajonit rane dakord qe ta zevendesojne rrjetin ekzistues te marreveshjeve bilaterale (mbi 30 marreveshje te tilla) me nje marreveshje **te vetme** (CEFTA). Epersite e ne marreveshje te vete ndaj rrjetit te marreveshjeve bilaterale jane te shumta. Disa prej ketyre epersive jane si vijon:

Marreveshja e **vetme** do te sjelle uniformitet rregullash dhe politikash, ne vend te rregullave dhe politikave te ndryshme per secilen marreveshje bilaterale.

Marreveshja e **vetme** do te permirsoje transparencen per kompanite qe operojne midis kufijve. Domethene nje kompani qe vepron ne disa vende te rajonit do te ndeshet me te njertat rregulla dhe politika, si ne Kosove ashtu dhe ne Maqedoni ose Shqipëri.

Marreveshja e **vetme** e Ben me te lehte zbatimin per qeverine. Ne vend te nje numri te madh marreveshjes bilaterale, qeveria implementon vetem nje marreveshje te perbashket.

Marreveshja e **vetme** permirëson bashkepunimin rajonal. Te gjitha vendet negociojne se bashku. Per Kosovën PSD., kjo marreveshje paraqet nje mundesi per te zgjidhur problemet tregtare me Serbine, gjë e cila nuk mund te behej ne menyre bilaterale.

Është e rëndësishme te theksohet se regjimi tarifor (përfshi edhe mbrojtjen e siguruar për prodhimet sensitive) i arritur ne marreveshjet bilaterale do te mbartet plotësisht ne CEFTA.

Cilat janë përfitimet e CEFTA-s?

Për një vend pa qasje ne det, integrimi rajonal ne pergjithësi, dhe marrëdhëniet e mira tregtare me vendet fqinje ne veçanti, marrin një rëndësi te veçante. Tregtia e lire është e domosdoshme për Kosovën sepse jo vetëm qe i mundëson importimin e lendeve te para dhe prodhimeve te gatshme qe nuk mund te prodhohen ne vend, po i siguron edhe qasje ne tregje me potencial për eksportet e saj.

Gjithashtu, është e rëndësishme te kuptohet qe investitorët e mëdhenj nuk janë aq te interesuar për tregun 2 milionësh te Kosovës, sa janë te interesuar për tregun rajonal prej 20-30 milionësh ku mund te shfrytëzojnë fuqinë punëtore dhe tregun e lendeve te para dhe ku mund te shesin me pas prodhimet e tyre. Gjithashtu, këta investitorë e shohin këtë treg rajonal edhe si mundësi për t'iu qasur ne menyre preferenciale tregut gjigant Evropian. Ky treg rajonal nuk do te materializohet nëse CEFTA nuk zbatohet efektivisht. Tregtia e lire është instrumenti me i rëndësishëm qe përcakton dimensionet e një tregu.

Megjithatë duhet te kuptohet qe CEFTA nuk ofron zgjidhje magjike, por mundësi për te zgjidhur probleme. Me fjale te tjera, nëse mundësitë qe ofron CEFTA nuk shfrytëzohen efektivisht, përfitimet

biznesit, sipërmarrësit dhe shoqëria ne përgjithësi i kuptojnë obligimet dhe përfitimet e CEFTA-s dhe bashkëpunojnë për te arritur Qeveria e Kosovës dhe ne veçanti Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ne bashkëpunim me institucionet e tjera partnere ndërkombëtare janë duke punuar ne mënyre qe te ngrihet infrastruktura e nevojshme institucionale ne mënyre qe ti përgjigjemi efektivisht sfidave te CEFTA-s dhe për te rritur ne maksimum përfitimet e Kosovës.

Përfitimet e CEFTA-s mund te shikohen nga disa këndvështrime. Me konkretisht po ndalem ne dy këndvështrime për ti shqyrtuar këto përfitime.

Nga këndvështrimi politik është e padiskutueshme se Kosova ka vetëm përfitime nga CEFTA. Kosova është bere pjesëmarrëse me sovranitet te plote ne ketë iniciative rajonale. Kosova nuk ka mbetur vrime e zeze ne Ballkan, peng i zgjidhjes se statusit, por aktivisht e ka shprehur vullnetin e saj për te qene pjese integrale e rajonit. Gjithashtu, duke u bere pjese e CEFTA-s Kosova është pjese e mekanizmit te bashkëpunim rajonal qe promovon stabilitetin politik ne rajon. Ne ketë mënyre, Kosova i zgjidh problemet me dialog dhe bisedime, e jo me konfrontime e kërcënime. Për me tepër, CEFTA e rrit fuqinë negociuese te Kosovës përballë vendeve me te mëdha te rajonit. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve qe Kosova ka me vendet e rajonit behet pjese e zgjidhjeve te problemeve te rajonit ku te gjitha palët ushtrojnë presion mbi palën diskriminuese. Zgjidhja e problemeve ne mënyre bilaterale do te ishte gjithmonë me e vështire për Kosovën, sidomos me Serbinë me te çilen ne kemi gatur gjithmonë me shume probleme tregtare e qe kane qene gjithmonë te vështira për tu zgjidhur për shkak te mungesës se vullnetit nga pala Serbe për ti diskutuar këto probleme.

Edhe nga aspekti ekonomik përfitimet janë te shumta. Se pari, Kosova ndërmerr një numër obligimesh për reforma institucionale ne fusha shume te rëndësishme si Ndihma Shtetërore, Konkurrenca, Prokurimet Publike, etj. Këto reforma përndryshe do te ishin shume te vështira për tu ndërmarre për shkak te energjive politike dhe administrative qe kërkojnë. Ne ketë kontekst, CEFTA do te shërbeje si nxitëse e këtyre reformave dhe do te na ndihmoje duke na ofruar zgjidhjet me te mira ne rajon. Se dyti, nëpërmjet CEFTA-s rajoni do te beje harmonizimin e politikave, institucioneve, ligjeve e procedurave. Kjo e Ben me tërheqës rajonin për investitorët e huaj, sepse ata nuk do te preferonin te vepronin ne një treg rajonal ku rregullat e lojës ndryshojnë sa here qe kapërcejnë një kufi.

Po ne aspektin ekonomik është e rëndësishme te kuptohen edhe përfitimet e konsumatorit Kosovar. Për Qeverinë e Kosovës mirëqenia e konsumatorit Kosovar është një pjese e rëndësishme e interesit publik. Nëpërmjet CEFTA-s zgjerohen mundësitë e konsumatorit për çmime me kompetitive dhe zgjedhje me te madhe te cilësisë.

Mirëqenia e biznesit kosovar është pjese po aq e rëndësishme e interesit publik sa edhe mirëqenia e konsumatorit. Çfare do te përfitojnë bizneset e Kosovës nga CEFTA? Kjo është teme shume e diskutuar dhe natyrshëm eshë pjesa me sensitive e debateve mbi CEFTA-n. Shqetësimet qe ngrëne disa biznese mbi konkurrencën me te çilen ato mund te përballen janë te logjikshme duke qene se ne parim CEFTA nënkupton liberalizim te tregtisë. Po edhe ne ketë pike, përfitimet dhe kostot e CEFTA-s duhen pare ne kompleks dhe jo te ndara nga konteksti i gjere ne te cilin ajo vepron.



REPUBLIKA E KOSOVËS

QEVERIA E KOSOVËS

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË

Adresa

*Perandori Justinian
Qyteza Pejton 3-5
Prishtine – Kosovë*